



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Kryetarja e Komunës**

01nr 400-22393

Dt: 25.04.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve dhe Përfundimit nr.06-16297-8/1 të miratuar me dt: 30.03.2016 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, me të cilin është miratuar kërkesa e Shoqatës së ish të “Burgosurve Politikë 143+2” të Gjakovës me dt: 25.04.2016 e miraton këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës së ish të “Burgosurve Politikë 143+2” të Gjakovës e evidentuar me nr. 01.400-13130 të dt. 11.03.2016, për mbulimin e shpenzimeve operative sipas planit të shpenzimeve të paraqitur në këtë kërkesë, duke e mbështetur me subvencione të Zyrës së Kryetares në vlerë prej 1,500.00€.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,500.00€ nga mjetet e subvencioneve të Zyrës së Kryetares dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e Shoqatës së ish të “Burgosurve Politikë 143+2” të Gjakovës, nr. 1402000001764850 Banka Ekonomike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Vendimi iu dërgohet:
  - Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
  - Z. Afrim Caka, kryetar i shoqatës së ish të “Burgosurve Politikë 143+2” të Gjakovës
  - Arkivit

**Kryetarja e Komunës,**

**Znj. Mimoza Kusari-Lila**

*sipas aut 22/04/16*

